

VENDIM
Nr.568, datë 23.8.2006

**PËR KALIMIN E DISA MJEDISEVE NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË
SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, PËR
AGJENCINË E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË
ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE (ALUIZNI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Këshilli i Ministrave te Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) të disa mjediseve, me sipërfaqe: ndërtesë 970 m², truall nën ndërtesë 630 m² dhe sipërfaqe funksionale trualli 350 m² (ish-Instituti i Perime-Patateve), sipas planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Godina e Institutit te Perim Patateve Plani i katit perdhe



Godina e Institutit te Perim Patateve Plani i katit I



Godina e Institutit te Perim Patateve Plani i katit II

